

BASHKIA SHKODËR
SHERBIMI I PASTRIMIT TE QYTETIT
2013

DOKUMENTACIONI I TENDERIT

PASQYRA E LËNDËS

1.	MBLEDHJA DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE URBANE	6
1.1	Objekti i shërbimit	6
1.2	Volumi dhe organizimi i punës	6
1.2.1	Frekuenca e mbledhjes/grumbullimit	7
1.2.2	Orari	7
1.2.3	Raportimi, monitorimi	7
1.3	Mjetet dhe pajisjet	10
1.4	Evolucioni i shërbimit	11
1.5	Metodat e pagesës	11
2.	RICIKLIMI	12
2.1	Pikat e grumbullimit	12
2.2	Blerja e mbetjeve nga sektori informal	13
2.3	Mbledhjet e mbetjeve specifike në zonat industriale dhe të biznesit	13
2.4	Impianti i Riciklimit	14
2.5	Metodat e pagesës	14
2.6	Koment për riciklimin	14
3.	MENAXHIMI I VEND-DEPOZITIMIT	15
4.	MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA E KAZANËVE	15
5.	FSHIRJA DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE	16
5.1	Objekti i shërbimit	16
5.2	Fshirja mekanike e rrugëve	17
5.2.1	Volumi dhe organizimi i punës	17
5.2.2	Mjetet dhe pajisjet	17
5.2.3	Metodat e pagesës	18
5.3	Fshirja manuale	18
5.3.1	Volumi dhe organizimi i punës	18
5.3.2	Mjetet dhe pajisjet	18
5.3.3	Metodat e pagesës	18
5.4	Mirëmbajtja e rrugëve	18
5.4.1	Volumi dhe organizimi i punës	18
5.4.2	Metodat e pagesës	18
6.	LARJA E RRUGËVE	19
6.1.1	Volumi dhe organizimi i punës	19
6.2	Mjetet dhe pajisjet	19
6.3	Metodat e pagesës	19

7.	FUSHATAT E INFORMIMIT	20
8.	PENALITETET/GJOBAT	20
9.	KËRKESAT PËR OFERTUESIN	22

VËREJTJE DHE KOMENTE

Identifikimi i kapitujve kryesorë i referohet zërave të llogaritjes së kostove.

Ky raport përfshin propozimet për pikat kryesore që do të jenë pjesë e pjesës teknike të dokumentacionit të tenderit si edhe kontratën me Bashkinë.

Hollësitë dhe pjesët ligjore do të plotësohen nga Bashkia.

Ky raport është teksti i përbashkët për dy tendera që do të zhvillohen. Specifikimet për zonën Veriore do të shënohen me të gjelbër, ndërsa ato për zonën Jugore do të shënohen me ngjyrë blu.

Në lidhje me menaxhimin e vend-depozitimit dhe menaxhimin të mbetjeve inerte, propozohet rindarja e mëposhtme:

Shoqëria e pjesës Jugore

0% e volumit të punës për menaxhimin e vend-depozitimit

60% e volumit të punës për mbledhjen e mbetjeve inerte dhe voluminoze

Shoqëria e pjesës Veriore

100% e volumit të punës për menaxhimin e vend-depozitimit

40% e volumit të punës për mbledhjen e mbetjeve inerte dhe voluminoze

Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve urbane

Objekti i shërbimit

Objekti i këtij shërbimi është mbledhja me një nivel të lartë cilësie e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Shkodër.

Ai përfshin mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane si mbetjet organike dhe inorganike familjare si edhe transportimin e tyre në vend-depozitim.

Mbetjet industriale dhe ato spitalore nuk mbulohen nga ky shërbim.

Volumi dhe organizimi i punës

Shërbimi mbulon pjesën Jugore dhe Veriore të Bashkisë Shkodër si edhe banorët dhe bizneset e saj. Numri total zyrtar i banorëve të Qytetit është rreth 113.350 (regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 2010), 60% e të cilëve banojnë në pjesën Jugore dhe 40% në pjesën Veriore të Qytetit.

Një sasi prej 76 ton duhet grumbulluar çdo ditë në të gjithë Qytetin, 7 ditë në javë, 52 javë në vit. Kjo sasi është llogaritur gjatë një fushate vlerësimi, e realizuar në mars të vitit 2013. Kjo përfaqëson një sasi prej 46 dhe 30 ton në zonën ku ofrohet shërbimi.

Mbetjet grumbullohen nëpërmjet 360 dhe 240 kazanëve me kapacitet 1.100 litra, të vendosur në rrugët e

qytetit sipas planit të Bashkisë. Pronësia e këtyre kazanëve do t'i kalojë Shoqërisë së përzgjedhur.

Gjatësia totale e rrugëve në zonën Jugore dhe Veriore ku grumbullohen kazanët është rreth 36 dhe 24 km. Pozicioni i kazanëve në këto rrugë përcaktohet nga Bashkia kështu që distanca maksimale e shërbimit për popullatën është 200 metra.

Herë pas here, Zyra Qendrore mund t'i kërkojë shoqërisë të mbledhë mbetjet në zonat e pambuluara. Shoqëria do të përfshijë në ofertën e saj një shumë të përgjithshme (shtesë) për këtë punë të rastit.

Vend-depozitimi ekzistues i marrë parasysh në kontratë gjendet në territorin e komunës Guri i Zi, në një largësi prej 3 km nga qendra e qytetit. Duhet të merret parasysh edhe depozitimi i ardhshëm në landfillin zyrtar të Bushatit dhe kjo do të çonte në përshtatjen e kostove të transportit dhe depozitimit.

Meqë në vend-depozitim aktual nuk ka një peshore të disponueshme, gjithë kontrolli dhe pagesa e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve do të bazohet në numrin e kazanëve të grumbulluar dhe jo të tonëve.

Frekuenca e mbledhjes/grumbullimit

Në të gjithë Qytetin, shërbimi kryhet çdo ditë, nga e hëna në të dielë.

Orari

Mbledhja e mbetjeve në qendrën e qytetit do të bëhet gjatë natës (nga ora 22.00 derinë orën 05.00) për të shmangur trafikun dhe për të lejuar grumbullimin e produkteve të mbetjeve ditore.

Grumbullimi i mbetjeve në rrethina mund të bëhet gjatë ditës ose gjatë natës.

Për qendrën e qytetit, orari i grumbullimit mund të zgjatet edhe gjatë ditës, vetëm me marrëveshje me Bashkinë, për të realizuar shërbimin sa më mirë apo në raste specifike (si për shembull në zonën e tregut).

Shoqëria do të ofrojë hartën e rrugëve ku do të kryhet grumbullimi i mbetjeve dhe orarin e shërbimit.

Raportimi, monitorimi

Ekipi i monitorimit i Bashkisë do të jetë përgjegjës për monitorimin e cilësisë dhe sasisë së shërbimit. Organizimi dhe detyrat e ekipit të monitorimit do të jenë si më poshtë:

A. Bashkia

Përcakton prioritetet, bazat e tenderave, planin e menaxhimit të mbetjeve

Përcakton strategjinë për mbledhjen e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve

Cakton buxhetet, miraton faturat, duke përfshirë edhe penaltitetet/gjobat

Negocion me shoqërinë në rast mosmarrëveshjeje

B. Kryetaret e rajoneve (+ inspektorët)

Roli : kontrolli i shërbimit që i ofrohet popullatës, dhe raportimi

Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimeve: kazanët që nuk janë mbledhur, rrugët që nuk janë fshirë, pikat e grumbullimit që nuk janë pastruar, kazanët e dëmtuar dhe ato të zhdukur

Verifikon dhe përshtat nevojat e kazanëve:

Kur ka shumë kazanë (kazanët janë bosh): propozon reduktimin e numrit të tyre

Kur nuk ka kazanë të mjaftueshëm (kazanët janë të mbushur plot dhe ka mbetje në rrugë): propozon shtimin e numrit të kazanëve

Propozon zhvendosjen apo shtimin e pikave të grumbullimit

Identifikon nevojat e veçanta: mbetjet inerte, ngjarjet dhe i bën propozime mbikëqyrës

I jep informacion:

Shoqërisë + mbikëqyrës, menjëherë për çdo mangësi në cilësi/sasi:

kazanët që nuk janë grumbulluar (pozicioni i kazanit, dita dhe ora e vëzhgimit)

rrugët që nuk janë fshirë (rrugët, dita dhe ora e vëzhgimit)

kazanët e dëmtuar (pozicioni i kazanit, rruga, lloji i dëmtimit, dita dhe ora e vëzhgimit)

kazanët që nuk janë larë çdo muaj

mbikëqyrës, çdo muaj, sintezën e mangësive të cilësisë:

raport mujor, si bazë e raportit për bashkinë, dëmshpërblimet dhe penalitetet/gjobat e mundshme

C. Mbikëqyrësi

Roli: kontrolli i respektimit të kontratës, verifikimi i faturave dhe propozimi për pagesat ndaj shoqërisë dhe penalitetet/gjobat

Punët në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Departamentit të Shërbimeve Publike

Përcakton prioritetet dhe i jep shoqërisë urdhra për nevoja të veçanta (mbetjet inerte, ngjarjet, zhvendosjen e kazanëve, etj.) në kuadrin e buxhetit

Harton statistikat dhe bën kontrollin e sasive

të dhënat e shoqërisë (mirëmbajtja e kazanëve, orari i grumbullimit, itineraret, kilometrat, punonjësit, etj.)

të dhënat e Zyrës Qendrore dhe kontrollorit në landfill.

Harton raportet javore dhe mujore për Bashkinë, në bazë të raporteve të Zyrës Qendrore, si edhe statistikat:

Sasitë e shërbimeve:: kontrolli dhe miratimi i faturave

Mangësitë në cilësi: kazanët që nuk janë grumbulluar, rrugët që nuk janë fshirë, vendet e grumbullimit që nuk janë pastruar, kazanë të dëmtuar, depozitimi i mbetjeve jashtë landfillit

Bën propozimet për Bashkinë në lidhje me penalitetet/gjobat, nëse është e nevojshme, në bazë të kontratës, raportet e Zyrës Qendrore dhe të dhënat statistikore

Vendos në lidhje me reduktimin apo zhvendosjen e kazanëve apo propozon rritjen e numrit të tyre, nëse është e nevojshme

Bën propozimin për shpenzimet e veçanta, dhe ndihmon në përgatitjen e buxhetit vjetor për Bashkinë

shpenzime të veçanta jashtë buxhetit (mbetje inerte, pika të hapura, etj.)

blerje kazanësh të rinj

modifikimi i buxhetit vjetor

D. Kontrollori i vend-depozitimit

Roli: kontrolli dhe raportimi i veprimtarive në vend-depozitim

Varet direkt nga Bashkia

Kontrollon dhe mbledh informacion në lidhje me sasitë e shërbimeve

Raporton për çdo kamion: numri i identifikimit të kamionit, orët e punës, lloji i mbetjeve (nëse janë të veçanta)

Raporton në lidhje me orët e punës së makinerisë

Raporton për ngjarje të veçanta në vend-depozitim: zjarr, aksident etj.)

Kontrollon cilësinë e mbetjeve

Informon mbikëqyrësin nëse po vijjnë mbetje jo në përputhje me normat, shoferin e kamionëve (të huaj, etj.)

Harton raporte javore për mbikëqyrësin

Vendi i punës i Kontrollorit është një kabinë e blerë nga shoqëria përgjegjëse për pjesën Veriore të Qytetit

Të dhënat statistikore

Kontraktuesi duhet të mbajë të dhënat statistikore ditore në lidhje me pikat kryesore të mëposhtme dhe t'ia raportojë mbikëqyrësit çdo muaj, të printuara në letër dhe në formë dixhitale:

Numrin e kazanëve të ngarkuar në çdo rrugë

Orët reale të grumbullimit: orën ditore të nisjes së kamionëve, orën e shkarkimit të mbetjeve në landfill, orën e kthimit në garazh

Kilometrazhin ditor të çdo kamioni

Konsumin e karburantit dhe vajit të çdo kamioni, operacionet e mirëmbajtjes dhe datën e zhvillimit të tyre

Numrin dhe itinerarin e rrugëve të bëra nga kamionët

Listën e rrugëve të fshira dhe të lara, orët ditore të fshirjes dhe larjes mekanike (me makineri teknologjike)

Listën e punonjësve dhe orët e punës

Inventarin mujor të kazanëve, për çdo rrugë, me numër identifikimi dhe gjendjen e tyre

Zhvendosjen, mirëmbajtjen apo humbjen e kazanëve, kazanët e larë: listën e kazanëve përkatës (rruga, numri i identifikimit), riparimi specifik, data

Komente në lidhje me kërkesat e Kryetareve të rajoneve apo mbikëqyrësit për mangësitë në cilësi apo sasi

Në raportin mujor, kontraktuesi i propozon mbikëqyrësit modifikimet e mëposhtme:

Propozon shtimin e kazanëve atje ku është e nevojshme

Propozon reduktimin e numrit të kazanëve atje ku është e nevojshme apo zhvendosjen e tyre

Propozon shtimin e pikave të reja të grumbullimit

Propozon të gjitha mundësitë për përmirësimin e shërbimeve, rikuperimin e mbetjeve, etj,

Mjetet dhe pajisjet

Kërkesat për kamionët:

Një numër minimal prej 3 dhe 2 kamionësh për ngjeshjen/presimin e mbetjeve për mbledhjen e mbetjeve me kapacitet 10 ton në gjendje optimale pune kërkohen për ofrimin e shërbimit.

Në përgjithësi, kamionët duhet të jenë në gjendje të mirë për të lejuar grumbullimin e 10 ton mbetjeve në qytet në më pak se katër orë.

Kamionët e mbledhjes së mbetjeve duhet të kenë nga prapa një sistem ngritës të përshtatshëm të pajtueshëm me kazanët e përdorur në Bashkinë Shkodër. Shembulli i sistemit të ngritjes së kazanëve mund të shikohet në foton e mëposhtme:

Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë plotësisht funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli (ngritja e kazanit, shkarkimi dhe ngarkimi i tij me një kazan plot (130 kg) brenda një harku kohor të kufizuar në 20 sekonda.

Punëtorët nuk duhet t'i mbajnë në krahë kazanët për t'i vendosur në sistemin mekanik të ngritjes.

Kamionët duhet të jenë në gjendje të mirë, të mos kenë rrjedhje karburanti/vaji/uji, për të punuar 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme, pa ndërprerje për arsye mekanike, si edhe të ecin me shpejtësi 80 km/orë.

Kamionët duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe normat e sigurisë.

Dritat e përparme dhe ato të prapme duhet të jenë në gjendje të mirë dhe kamionët duhet të jenë të pajisur me pasqyra reflektuese.

Kamionët duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të parë prapa, këmbalka dërrase dhe doreza për punëtorët, sistem komunikimi (radio apo telefon) për t'u lidhur me qendrën operative.

Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të mundësuar një faktor të mirë ngjeshjeje dhe për të ngarkuar sasinë e kërkuar të mbetjeve, në vëllimin e kamionit (përkatësisht 10 dhe 5 ton).

Investimet, kostot e mirëmbajtjes dhe nëse është e nevojshme kostot e zëvendësimit, si edhe kostot operative paguhen krejtësisht nga kontraktuesi.

Kontraktuesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionëve, në mënyrë që të gjithë të jenë në gjendje të mirë pune.

Nëse një mjet është jashtë funksioni, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë me shpenzimet e tij me një mjet të ngjashëm gjatë kohës së riparimit të mjetit që nuk punon. Këto rrethana nuk duhet të ndikojnë mbi cilësinë dhe sasinë e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.

Kamionët duhet të lahen çdo ditë. Ata duhet të sigurojnë një mbledhje të pastër dhe higjienike të mbetjeve.

Shoferi duhet të mbajë një libër ku të shënojë çdo ditë të dhënat e punës së kryer: orën e fillimit të punës, orën e ndalimit të shërbimit, orët e shkarkimit, numrin e rrugëve të bëra, numrin e kazanëve të grumbulluar.

Shoqëria duhet të sigurojë librin e mirëmbajtjes së kamionit, duke dhënë të gjithë informacionin në lidhje me karburantin (datat, orët, sasinë), vajin dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen.

Nëse kamionët nuk i përmbushin këto kërkesa, për shkak të neglizhencës apo mungesës së mirëmbajtjes nga ana e Shoqërisë, Bashkia mund të kërkojë zëvendësimin e mjeteve në fjalë.

Shoqëritë ofertuese duhet të bëjnë një prezantim të hollësishëm të kamionëve që propozojnë për mbledhjen e mbetjeve.

Personeli

Kontraktuesi merr në punë me shpenzimet e tij personel të kualifikuar të përbërë të paktën nga një shofer dhe tre punëtorë (ngarkim-shkarkimi) për kamion. Në rast mungesash, ai është përgjegjës për punësimin e personelit zëvendësues kompetent.

Kushtet e punës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontraktuesi është përgjegjës për marrjen e të gjitha masave për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve.

Personeli i kontraktuesit duhet të jetë gjithnjë i pajisur me doreza dhe rroba të përshtatshme pune që kanë shenjat dalluese të shoqërisë si edhe me sinjalistikën e duhur për sigurinë e punës gjatë natës.

Kazanët duhet të trajtohen me kujdes nga personeli i kontraktuesit, të boshatisen krejtësisht dhe të vendosen ashtu siç duhet në vendet e caktuara për ta. Riparimi i kazanëve të dëmtuar është në ngarkim të shoqërisë.

Ekipi i monitorimit i Bashkisë ka kompetencën e dhënies së udhëzimeve drejtuesit të personelit të kontraktuesit.

Shoqëria është përgjegjëse për trajnimin dhe arsimimin e personelit të saj në drejtim të praktikave të mira të punës. Kjo përfshin edhe ndalimin e futjes së mbetjeve në sistemin e grumbullimit të ujit.

Evucioni i shërbimit

Landfilli i Bushatit

Një landfill i kontrolluar është ndërtuar në komunën e Bushatit në vitet e fundit, në distance 16 km larg qendres së qytetit. (vend-depozitimi ekzistues është 3 km larg qendrës së qytetit). Në të ardhmen, mbetjet duhet të depozitohen në këtë landfill. Aneks-kontrata do të rishikohet sapo të krijohen kushtet për depozitim në landfill ose stacion perpunimi dhe mbetjet do të peshohen. Për efekt pagese do të bëhet konvertimi nga numri i kazanash në ton, sipas koeficientit të përcaktuar nga studimi i kryer nga Interkooperacioni Zvicëran ku një ton është i barabartë me 7.9 kazanë. Kjo do të shërbejë si bazë për aneks-kontraten e re.

Me fillimin e depozitimit në landfillin e Bushatit, sipërmarresit i zbritet fondi i parashikuar për menaxhimin e mbetjeve në venddepozitimin ekzistues.

Tarifat e landfillit do të paguhet drejtpërdrejt nga Bashkia dhe nuk përfshihen në çmimet e dhëna nga Shoqëria.

Metodat e pagesës

Brenda një diapazoni prej 360 (z. Jugore) dhe 240 (z. Veriore) kazanësh të grumbulluar në ditë $\pm 10\%$ të grumbulluar mesatarisht në ditë gjatë një muaji, 7 ditë në javë, përshtatjet e numrit të kazanëve të grumbulluar nuk do të shkaktojnë ndonjë ndryshim në vlerën e kontratës.

Jashtë këtij diapazoni, kostot do të ndryshojnë në varësi të numrit efektiv të kazanëve të grumbulluar. Çmimi njësi për llogaritjen e diferencës (lart apo poshtë) do të jetë 50% e çmimit njësi për ngarkimin e një kazanit.

Pasi mbetjet të jenë depozituar në landfill, pagesat do të bazohen në peshën e grumbulluar.

Kontrata për Grumbullimin, transportimin dhe largimin e mbetjeve, do të lidhet në masën 3% me të vogël se çmimi i ofruar nga operatori ekonomik fitues. Kjo sasi (3%), që do të jetë detyrim për kompaninë, konsiderohet si volum mbetjesh të ricikluara, që sjellin burim të ardhurash për vetë operatorin. Sqarimet me hollësi të pikës 2.

Kostot e zhvendosjes dhe mirëmbajtjes së kazanëve gjatë periudhës së zbatimit të kontratës janë përfshirë në pikën 4 "menaxhimi dhe mirëmbajtja e kazanëve".

Ju kujtojmë që:

Të gjitha pajisjet e përfshira në mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve, si kamionët apo kazanët janë pronësi e shoqërisë.

Mbetjet e grumbulluara në qytet, në bazë të kontratës me Bashkinë Shkodër janë pronësi e Bashkisë.

Riciklimi

Sipas ligjit nr. 10463 për menaxhimin e integruar të mbetjeve, dhe sipas strategjisë kombëtare për mbetjet, kontrata për grumbullimin e mbetjeve dhe pastrimin e qytetit të Shkodrës përfshin veprimtaritë e riciklimit dhe ofron një shërbim të ri për popullatën, industrinë dhe bizneset.

Si hap i parë, riciklimi do të fokusohet tek letra/kartoni, shishet PET dhe shishet prej plastike të fortë. Këto materiale do të grumbullohen veçmas dhe do të trajtohen në një "impiant riciklimi", pronë e Shoqërisë. Trajtimi përfshin një klasifikim/ndarje të dytë dhe formësimin e materialit në sfera të presuara. (shih §0 f.14).

Materialet do të grumbullohen nëpërmjet tre mënyrave të ndryshme:

Mënyrat e grumbullimit	Materiali i grumbulluar*
1. 2 pika grumbullimi (njëra në pjesën jugore të qytetit, tjetra në pjesën veriore)	Letër/karton, shishe PET, shishe prej plastike të fortë
2. Blerja e mbetjeve nga sektori informal	Shishe PET
3. Grumbullimi specifik në zonat industriale dhe ato të biznesit	Letër/karton

**kërkesa minimale, shoqëria është e lirë ta hapë këtë veprimtari edhe për materiale të tjera, me kusht që të marrë miratimin paraprak të Bashkisë.*

Pikat e grumbullimit

Këto janë dy vende, që gjenden përkatësisht në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit, ku qytetarëve u propozohet të sjellin mbetjet e tyre tashmë të paraklasifikuara/ndara, për të cilat do të marrin një shpërblim të vogël, në përpjesëtim me sasinë e mbetjeve të sjella. .

Shoqëria që ofron këtë shërbim duhet të krijojë këto pika grumbullimi dhe t'i pajisë siç do të përshkruhet në vazhdim.

Sipërfaqja e çdo pike grumbullimi është rreth 70 m², e rrethuar me gardh (34 m) dhe e asfaltuar. Ajo përfshin një kabinë të vogël për punëtorin, me infrastrukturë minimale: ujë, elektricitet, ngrohje dhe WC. Pikat e grumbullimit janë pajisur me një peshore industriale për të peshuar mbetjet dhe kazanët para magazinimit të tyre:

	Pikë grumbullimi në Jug	Pikë grumbullimi në Veri
Letër/karton	6 kazanë	5 kazanë
Shishe PET	4 kazanë me kosh të madh	3 kazanë me kosh të madh
Shishe të tjera plastike	3 kazanë me kosh të madh	2 kazanë me kosh të madh

Kazanët janë njësoj si ata që përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane (përshkrimi në§0, f.15). Koshat e mëdhenj do të lejojnë transportimin e shisheve prej plastike në kamion të hapur.

Peshorja duhet të jetë në gjendje të mbajë pesha nga 0 deri në 60 kg minimalisht.

Këto pika grumbullimi u propozohen qytetarëve që do të marrin një sasi të caktuar parsh për dërgimin e mbetjeve të tyre të klasifikuara/ndara atje, sipas disa kushteve:

	Çmimi (lek/kg)	Sasia min. (kg)	Sasia maks. (kg)*
Letër/karton	2	2.5	60
Shishe PET (të shtypura)	16	0.5	30
Shishe të tjera plastike (të shtypura)	9	0.5	30

**Për sasi më të mëdha, pronari i mbetjeve duhet të kontaktojë me shoqërinë.*

Mbetjet duhet të jenë paraklasifikuar/ndarë dhe pastruar ashtu siç duhet. Mbetjet e përziera apo të ndotura nuk do të pranohen.

Pikat e grumbullimit janë hapur çdo ditë, 8 orë në ditë.

Shishet PET dhe ato plastike transportohen në impiantin e riciklimit, në kamion të hapur, të paktën një herë në ditë, pasdite vonë (pas mbylljes së pikës së grumbullimit). Letra/kartoni grumbullohen 3 herë në javë, me një kamion teknologjik (shih §0 f.10).

Priten sasi të mëposhtme të mbetjeve të klasifikuara/ ndara:

	kg/ditë	ton/vit
Letër /karton	1'000	365
Shishe PET (të shtypura)	230	84
Shishe të tjera plastike (të shtypura)	230	84

Blerja e mbetjeve nga sektori informal

Pritet që Shoqëria të blejë mbetje të klasifikuara/ndara më parë nga sektori informal.

Priten sasi të mëposhtme të mbetjeve të klasifikuara/ndara:

	kg/ditë	ton/vit
Shishe PET	300	110

Mbledhjet e mbetjeve specifike në zonat industriale dhe të biznesit

Mbledhja specifike e letrës/kartonit organizohet tre herë në javë në zonat industriale dhe ato të biznesit me një kamion teknologjik, dhe duhet të bashkërendohet me transportin e letrës/kartonit që vjen nga pikat e grumbullimit. (§2.1, f. 8). Në ditët e grumbullimit, industrive dhe bizneseve do t'u kërkohet të nxjerrin mbetjet e tyre të letrës dhe kartonit.

Priten sasi të mëposhtme të mbetjeve të klasifikuara/ndara:

	kg/ditë	ton/vit
Letër/karton	1'500	548

Impianti i Riciklimit (impianti i presimit dhe paketimit)

“Impianti i riciklimit” operohet nga Shoqëria, e cila ka në pronësi vendin, ndërtesën dhe mjediset/pajisjet. Ai përbëhet nga elementet e mëposhtme:

Një rrugë e asfaltuar për kamionët (duke përfshirë kamionë transporti deri në 40ton)

Një vend i asfaltuar për pritjen dhe magazinimin e mbetjeve (të paktën një kapacitet magazinimi për 1 ditë)

Një ndërtesë me mjediset e riciklimit (e mbuluar)

Një vend magazinimi i asfaltuar për sferat e presuara

Një vend i asfaltuar për ngarkimin e sferave të presuara në kamionët e transportimit (i projektuar për kamionë 40 ton)

Ndërtesa përfshin një dhomë zhveshjeje për punëtorët, WC, ujë, elektricitete, ngrohje dhe ajrim/ventilim.

Pajisjet minimale të impiantit përfshijnë:

Një presë industriale sferash që respekton standardet e sigurisë dhe specifikimin e mëposhtëm: energji elektrike = 4W, forca e presimit = 16T

Kamion elektrik ngritës pirun, në gjendje të mirë, me kapacitet mbajtës 500 kg, shpejtësi lëvizjeje 10km/orë, shpejtësi ngarkimi 0.3 m/s, lartësi 2 m, pavarësia nga bateria 5 orë.

Alternative : një shirit transportieri për një klasifikim/ndarje të dytë manuale të mbetjeve (për të nxjerrë mbetjet e ndotura apo të paklasifikuara/ndara).

Impianti prodhon sfera të presuara të materialit të klasifikuar/ndarë që shiten në tregun kombëtar. Shoqëria mban një regjistër të mallrave të shitura, duke përfshirë edhe provat fizike për çdo transaksion (faturën e nënshkruar origjinale).

Metodat e pagesës

Nuk ka pagesë të drejtpërdrejtë nga Bashkia për këtë shërbim, meqë Shoqërisë i lejohet të shesë mallrat dhe ka mundësinë të nxjerrë fitime prej tyre (pritet një fitim prej 3% mbetje të ricikluara).

Bashkia përfiton nga reduktimi i kostove të transportit dhe depozitimit.

Koment për riciklimin

Shoqëria ka detyrimin të sigurojë mjetet dhe pajisjet për zhvillimin e veprimtarive të riciklimit, siç përshkruhet në këtë tender. Objektivi minimal është kapja e 3% e mbetjeve urbane/ bashkiake; të mblidhen 110 ton/vit shishe PET nga sektori informal dhe 550 letër/ karton nga industrinë dhe bizneset, mase e cila nxjerr shpenzimet operative për këtë shërbim. Tejkalimi i masës 3% mbetet fitim për kompaninë.

Ju kujtojmë që:

Zhvillimi i mëtejshëm i veprimtarive të riciklimit duhet t'i paraqitet Bashkisë për miratim.

Pasi mbetjet të jenë depozituar në landfillin e Bushatit, Shoqëria do të paguhet në bazë të peshës së

mbetjeve. Kostot e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane/bashkiake do të reduktohen në përpjesëtim me sasinë e mbetjeve të ricikluara.

Menaxhimi i vend-depozitimit

Ky zë/artikull kufizohet tek shoqëria përgjegjëse për pjesën Veriore të Qytetit.

Menaxhimi i vend-depozitimit ekzistues është detyrë e kontraktuesit dhe konsiston në:

Parandalimin e zjarreve,

Sheshimin/nivelimin e sipërfaqes,

Mbulimin e sipërfaqes me material inert për të lejuar lëvizjen e kamionëve,

Shmangien e zgjatimit në shtratin e lumit,

Kufizimin e hyrjes për kafshët dhe njerëzit,

Kufizimin e hyrjes dhe depozitimin e mbetjeve që vijnë nga jashtë fshatit dhe qytetit apo që vijnë nga burimet industriale dhe spitalore.

Menaxhimi i vend-depozitimit ekzistues do të bëhet nga shoqëria përgjegjëse për zonën Veriore të Qytetit.

Për këtë qëllim, kontraktuesi duhet të përdorë një mjet të përshtatshëm (kamion me ngarkim apo buldozer) dhe të punësojë një roje për vend-depozitimin.

Volumi i punës për makinerinë/mjetin vlerësohet në 5 ditë në muaj (38 orë).

Ekipi i monitorimit do të ketë një person të pranishëm në vend-depozitim gjatë orëve të grumbullimit, përgjegjës për kontrollin e mbërritjes, orët, llojin dhe të dhëna të tjera në lidhje me kamionin dhe mbetjet, si kontrollin dhe rakordimin e të dhënave të shoqërisë.

Për këtë qëllim, kontraktuesi i pjesës Veriore të Qytetit duhet të sigurojë një dhomë/zyrë (kabinë) në hyrje të vend-depozitimit për personelin e Bashkisë.

Pagesa e këtij shërbimi do të bazohet në orët e punës së makinerisë/mjetit dhe totalit për sigurimin e dhomës dhe rojës. Orët e punës së makinerisë/mjetit të çdo jave do të transmetohen çdo muaj nga Shoqëria dhe do të kontrollohen nga ekipi i monitorimit.

Sapo landfilli i ri të fillojë të përdoret, menaxhimi i vend-depozitimit do të rishikohet dhe mund të çojë në punime rehabilitimi në vend-depozitim.

Menaxhimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e kazanëve

Pronësia e kazanëve do t'i kalohet shoqërisë, e cila është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe zëvendësimin e tyre.

Menaxhimi i kazanëve:

Pozicioni i kazanëve caktohet nga Bashkia (lista e rrugëve me numrin dhe pozicionin e kazanëve). Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi duhet të ketë shtuar apo hequr kazanë nga vende të caktuara, me kërkesën e Bashkisë. Të gjitha lëvizjet e kazanëve janë përfshirë në çmim. Shoqëria duhet të posedojë një mjet për këtë qëllim.

Kazanët do të zëvendësohen në mënyrë progresive. Çmimi i shoqërisë do të përfshijë zëvendësimin e 15% të kazanëve (54– zona jugore dhe 36– zona veriore) çdo vit. Kazanët e rinj duhet të kenë të paktën të njëjtën cilësi si ata ekzistues: kazanë metalikë, me rrota, kapacitet 1.100 litra, të pajtueshëm me sistemin mekanik ngritës.

Shoqëria do të identifikojë çdo kazan me një numër specifik dhe të mbajë një bazë të dhënash të detajuar për kazanët, duke iu referuar numrit të identifikimit dhe pozicionit të tyre.

Mirëmbajtja e kazanëve:

Kazanët e dëmtuar duhet të riparohen sistematikisht nga kontraktuesi. Shoqëria është përgjegjëse për kryerjen e kontrollit dhe inventarit të përhershëm të kazanëve të dëmtuar, për zëvendësimin, largimin, riparimin dhe kthimin në vend të kazanëve të dëmtuar. Për këtë detyrë, ajo duhet të ketë një kamion dhe personelin e kërkuar për të siguruar transportimin e kazanëve për riparim. Shoqëria do të mbajë një stok prej 5 kazanësh për të zëvendësuar kazanët e dëmtuar në rast nevojë riparimi. Dëmet kryesore të konsideruara, që së pari duhen shmangur, dhe së dyti duhet të riparohen menjëherë kanë të bëjnë me:

rrotat,

mbulesat,

dorezat,

shformime të rëndësishme të trupit të kazanit.

Teksa kazanët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse trajtohen ashtu siç duhet. Pas grumbullimit, kazanët duhet të rivendosen në pozicionin fillestar të tyre.

Kontraktuesi duhet të ketë në dispozicion materialet dhe personelin e duhur për kryerjen e këtij shërbimi. Ai mund të jetë edhe një nënkontraktues.

Pagesa për këtë shërbim është totale (çdo muaj).

Ne pagesen prej 1800 lek per kazan, perfshihet edhe lyerja e tyre, nje here ne vit.

Larja e kazanëve:

Çdo kazan duhet të pastrohet dhe të lahet çdo muaj. Për këtë qëllim, kontraktuesi duhet të ketë në dispozicion materialet dhe personelin e kërkuar. Raporti në lidhje me operacionin e larjes duhet të përfshihet në raportin mujor.

Fshirja dhe mirëmbajtja e rrugëve

Objekti i shërbimit

Objekti i këtij shërbimi është pastrimi (fshirja dhe mirëmbajtja) e rrugëve me nivel të lartë cilësie.

Shërbimi ndahet si më poshtë:

Fshirja mekanike e rrugëve, gjatë natës

Fshirja manuale (me dorë) e trotuareve, shesheve dhe disa rrugëve, gjatë natës

Mirëmbajtja e rrugëve: gjatë ditës

Fshirja mekanike e rrugëve

Volumi dhe organizimi i punës

Zona e mbuluar nga fshirja mekanike e rrugëve është 169.877 m² (z. Jugore) dhe 167.693 m² (z. Veriore) (shih listën e hollësishme të përgatitur nga bashkia në Aneksin B)

Frekuenca e fshirjes mekanike është çdo dy ditë, nga e hëna në të shtunë, sipas listës së Bashkisë (shih Aneksin B). Fshirja mekanike do të realizohet gjatë natës, nga ora 22.00 deri në orën 6.00. Shoqëria do të përcaktojë rrugën dhe programin (orarin) e këtij shërbimi.

Fshirja e sipërfaqeve që zakonisht janë të paarrishme përgjatë trotuareve, ku parkohen makinat, do të organizohet rregullisht në bashkëpunim me Bashkinë.

Mjetet dhe pajisjet

Fshirja mekanike duhet të bëhet nga një kamion për fshirjen e rrugëve (fshesë teknologjike për fshirjen e rrugëve):

Kamioni duhet të ketë një kapacitet prej 8 m³.

Kamioni duhet të ketë një efikasitet të lartë në largimin e gjetheve, baltës dhe pluhurit si edhe një kapacitet fshirjeje më të madh se 140.000 m²/ditë

Kamioni duhet të pajiset me një sistem që pengon shpërhapjen e pluhurit në ajër (spërkatje me ujë)

Gjerësia minimale punuese e kamionit duhet të jetë 2 metra.

Kamioni duhet të jetë në gjendje të mirë pune, të mos ketë rrjedhje karburanti/vaji/uji, për të qenë në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme, pa ndërprerje për arsye mekanike, dhe të lëvizë me shpejtësi 30 km/orë.

Pavarësia e mjetit me një rezervuar plot duhet të jetë 10 orë.

Furçat duhet të jenë në gjendje të mirë për të hequr mbetjet, gjethet, baltën dhe pluhurin me efikasitet.

Kamioni duhet të pajiset me pasqyra të jashtme me pamje nga prapa për të lejuar vështrimin në pjesën e prapme.

Dritat/fenerët e përparmë dhe ata të prapmë duhet të jenë në kushte të mira dhe kamioni duhet të jetë i pajisur me pasqyra (reflektorë) dhe dritë sinjalizimi.

Investimet dhe kostot e mirëmbajtjes, si edhe kostot operative, paguhen plotësisht nga kontraktuesi.

Kontraktuesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionit, kështu që të gjithë kamionët janë në gjendje të mirë pune.

Nëse mjeteve është jashtë shërbimi, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë me një mjet të ngjashëm me shpenzimet e tij.

Nëse kamioni nuk përmbush këto kërkesa, për shkak të neglizhencës apo mungesës së mirëmbajtjes nga Shoqëria, Bashkia mund të kërkojë zëvendësimin e mjeteve në fjalë.

Shoqëritë ofertuese duhet të paraqesin një përshkrim të hollësishëm të mjeteve të propozuara për fshirjen mekanike.

Metodat e pagesës

Pagesa e këtij shërbimi do të bëhet në bazë të sipërfaqeve efektive të fshira, sipas rrugës dhe programit/orarit të përcaktuar për shërbimin. Kontrollat do të bëhen nga Bashkia.

Fshirja manuale

Volumi dhe organizimi i punës

Fshirja manuale (me dorë) konsiston në largimin e mbetjeve, gjetheve, baltës dhe pluhurit. Materialet e grumbulluara duhet të depozitohen në kazanët e mbetjeve.

Zona e mbuluar nga fshirja mekanike e rrugëve është përkatësisht **70.510 m² (duke përfshirë 30.510 m² trotuare)** dhe **61.085 m² (duke përfshirë 21.085 m² trotuare)**, sipas listës së përgatitur nga Bashkia (shih Aneksin B).

Frekuenca e fshirjes manuale është çdo ditë, nga e hëna në të dielë. Shoqëria do të caktojë rrugën dhe programin/orarin për këtë shërbim.

Mjetet dhe pajisjet

Çdo punëtor duhet të pajiset me veglat e duhura si karrocë dore, fshesa, lopatë dhe kazmë. Punëtorët duhet të veshin rroba pune të përshtatshme që mbajnë shenjat dalluese të shoqërisë.

Shoqëria është përgjegjëse për trajnimin dhe edukimin e personelit të saj me praktikën e mira të punës. Kjo përfshin edhe ndalimin e hedhjes së mbetjeve në sistemin e grumbullimit të ujit.

Metodat e pagesës

Pagesa e këtij shërbimi do të bëhet në bazë të sipërfaqeve efektive të fshira, sipas rrugës dhe programit/orarit të përcaktuar për shërbimin. Kontrollët do të bëhen nga Bashkia.

Mirëmbajtja e rrugëve

Volumi dhe organizimi i punës

Mirëmbajtja e rrugëve konsiston në largimin e mbetjeve dhe pastrimin e pikave të grumbullimit përgjatë **36** dhe **24** km rrugë ku ndodhen kazanët e mbetjeve.

Frekuenca e mirëmbajtjes është ditore, 7 ditë në javë.

Mirëmbajtja duhet të realizohet në bashkërendim me mbledhjen e mbetjeve kështu që mbetjet depozitohen në kazanë para se të mbërrijë kamioni i grumbullimit.

Metodat e pagesës

Pagesa e këtij shërbimi do të bazohet në gjatësinë efektive të rrugës së mirëmbajtur.

Larja e rrugëve

Volumi dhe organizimi i punës

Ky zë/artikull kufizohet tek shoqëria përgjegjëse për pjesën Veriore të Qytetit.

Qëllimi i këtij shërbimi është freskimi i rrugëve i paraqitur në listën e anekseve (Aneksi b), në periudhën e verës.

Sipërfaqja totale e qytetit e mbuluar nga larja e rrugëve është dhe **162.684** m² rrugë të asfaltuara, sipas listës së rrugëve.

Frekuenca e larjes është çdo ditë, 200 ditë në vit (nga 1 prill deri më 31 tetor), nga ora 4.00-8.00 dhe nga ora 17.00- 20.00.

Mjetet dhe pajisjet

Për larjen e rrugëve duhet përdorur vetëm ujë i pastër.

Larja duhet bërë me një kamion për larjen e rrugëve:

Kamioni duhet të pajiset me një rezervuar me kapacitet 20 m³ dhe me një pompë.

Kamioni duhet të pajiset për spërkatjen e rrugës me ujë me një gjerësi punuese minimale prej 2 metrash.

Konsumi i ujit duhet të jetë rreth 1 litër për m² (mbulohet nga Shoqëria)

Kamioni duhet të jetë në gjendje të mirë pune, të mos ketë rrjedhje karburanti/vaji/uji, për të qenë në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme, pa ndërprerje për arsye mekanike, dhe të lëvizë me shpejtësi 80 km/orë.

Kamioni duhet të pajiset me pasqyra të jashtme me pamje nga prapa për të lejuar vështrimin në pjesën e prapme.

Dritat/fenerët e përparmë dhe ata të prapmë duhet të jenë në kushte të mira dhe kamioni duhet të jetë i pajisur me pasqyra (reflektorë).

Investimet dhe kostot e mirëmbajtjes, si edhe kostot operative, paguhen plotësisht nga kontraktuesi.

Kontraktuesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionit, kësaj që gjithë kamionët janë në gjendje të mirë pune.

Nëse mjeti është jashtë shërbimi, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë me një mjet të ngjashëm me shpenzimet e tij.

Nëse kamioni nuk përmbush këto kërkesa, për shkak të neglizhencës apo mungesës së mirëmbajtjes nga Shoqëria, Bashkia mund të kërkojë zëvendësimin e mjeteve në fjalë.

Shoqëritë ofertuese duhet të paraqesin një përshkrim të hollësishëm të mjeteve të propozuara për fshirjen mekanike.

Metodat e pagesës

Pagesa e këtij shërbimi do të bazohet në sipërfaqet efektive të lara.

Fushatat e informimit

Në bashkëpunim me Bashkinë, Shoqëria do të organizojë një fushatë informimi, për qytetarët, institucionet dhe punëtorët. Objektivat e kësaj fushate janë:

Të shpjegojë pse është e rëndësishme që mbetjet të vendosen në kazanë dhe të mos hidhen në rrugë

Të shpjegojë pse mbetjet nuk duhen hedhur në sistemin e mbledhjes së ujërave

Të tregojë se si çdonjëri mund të kontribuojë në pastërtinë e qytetit

Të sensibilizojë popullsinë në lidhje me koston e shërbimit të ofruar dhe domosdoshmërinë e mbledhjes të taksave

Penalitetet/Gjobat

Ekipi i monitorimit do të jetë përgjegjës për kontrollin e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve. Elementet kryesore janë:

Penaliteti/gjoba 1, për kazanët e dëmtuar

Synimi: të shmanget reduktimi i efikasitetit të mbledhjes së mbetjeve nga kazanët e dëmtuar

Përgjegjësia: Shoqëria duhet të identifikojë dhe riparojë të gjithë kazanët e dëmtuar. Shoqëria duhet t'i lajë kazanët çdo muaj .

Kontrolli: Zyra Qendrore do të kontrollojë të gjithë kazanët e dëmtuar apo kazanët që nuk janë larë. Shoqëria duhet ta zëvendësojë kazanin me një tjetër dhe ka 5 ditë në dispozicion për të riparuar kazanin e dëmtuar. Shoqëria i jep mbikëqyrësit listën e kazanëve të dëmtuar që po riparohen dhe listën e kazanëve të larë në raportin mujor

Kriteret: Më shumë se 3% të kazanëve të dëmtuar apo të palarë (të raportuar në rrugë apo në riparim) të raportuar në raportin mujor

Penaliteti/gjoba: reduktimi me 5% i çmimit mujor për mbledhjen e mbetjeve për çdo 3% kazanë të dëmtuar apo pjesë të tij.

Penaliteti/gjoba 2, për kazanët që nuk janë grumbulluar

Synimi: të sigurohet cilësia maksimale e grumbullimit, ta detyrojë shoqërinë të ofrojë zgjidhje alternative në rast problemesh (mekanike, personale, etj.)

Përgjegjësia: Shoqëria duhet të grumbullojë çdo kazan në frekuencën e kërkuar

Kontrolli: Zyra Qendrore do të kontrollojë dhe do t'i raportojë Shoqërisë dhe mbikëqyrësit nëse grumbullimi nuk është kryer, duke treguar vendin, numrin, datën dhe orën e vëzhgimit

Kriteret: penalitet/gjorbë nëse më shumë se 10 kazanë rezultojnë të pagrumbulluar gjatë muajit

Penaliteti/gjoba: reduktim me 150% i çmimit për grumbullimin e një kazani për çdo kazan që nuk është grumbulluar

Penaliteti/gjoba: 3, për kazanët që nuk janë zëvendësuar

Synimi: të sigurohet që kazanët e dëmtuar që nuk mund të riparohen, ose zhdukur janë zëvendësuar nga Shoqëria, për të garantuar praninë e numrit të kërkuar të kazanëve në rrugë, siç është përcaktuar nga Bashkia

Përgjegjësia: Shoqëria duhet të zëvendësojë kazanët që nuk mund të riparohen

Kontrolli: Zyra Qendrore do të kontrollojë dhe do t'i raportojë shoqërisë, me informacionin e mbikëqyrësit , nëse kazanët mungojnë, duke treguar vendin, numrin, datën dhe orën e vëzhgimit

Kriteret: penaliteti/gjoba për çdo kazan që mungon, për çdo muaj

Penaliteti/gjoba: reduktim me 150% i çmimit për grumbullimin e një kazani për çdo kazan që nuk është grumbulluar

Penaliteti/gjoba: 4, për rrugët që nuk janë fshirë

Synimi: të sigurohet cilësia maksimale e fshirjes, ta detyrojë shoqërinë të ofrojë zgjidhje alternative në rast problemesh (mekanike, personale, etj.)

Përgjegjësia: Shoqëria duhet të fshijë çdo rrugë sipas programit dhe frekuencës së kërkuar, dhe të gjejë zgjidhje alternative nëse nevojitet

Kontrolli: Zyra Qendrore do të kontrollojë dhe raportojë në rast se nuk është bërë fshirja e rrugëve

Kriteret: penaliteti/gjoba nëse më shumë se 2 % e sipërfaqes nuk është fshirë gjatë një muaji apo më shumë se 10 ditë pa një makineri funksionale në një muaj

Penaliteti/gjoba: reduktim me 150 % e çmimit të fshirjes së rrugëve për sipërfaqen e pafshirë të rrugëve

Penaliteti/gjoba: 5, për depozitimin e mbetjeve në vendin e gabuar

Synimi: të shmanget rreptësisht që shoqëria të depozitojë mbetje në vendin e gabuar pa një marrëveshje paraprake dhe formale me Bashkinë

Përgjegjësia: Shoqëriaduhet t'i depozitojë mbetjet në vendin e kërkuar

Kontrolli: Zyra Qendrore, mbikëqyrësi apo ndonjë zyrtar do të kontrollojë dhe raportojë në rast depozitimi të mbetjeve në vendin e gabuar

Kriteret: penaliteti/gjoba për çdo depozitim të gabuar nga kamioni i shoqërisë

Penaliteti/gjoba: reduktim me 5 % e çmimit total mujor për mbledhjen e mbetjeve për çdo kamion të përfshirë. Detyrimi i shoqërisë për t'i marrë sërish mbetjet dhe për të pastruar vendin me shpenzimet e saj

Penaliteti/gjoba 6, për mos-raportim apo për raportimin e të dhënave të gabuara

Synimi: të sigurohet që shoqëria të bëjë çdo muaj raportimin dhe të japë të dhënat e kërkuara statistikore, dhe që ato të përputhen me realitetin

Përgjegjësia: Shoqëria duhet të japë çdo muaj, në datën 15 të muajit pasardhës, të dhënat e kërkuara, dhe i raporton mbikëqyrësit të dhënat reale dhe të sakta

Kontrolli: Mbikëqyrësi do të kontrollojë datën e marrje së raportit dhe do të kontrollojë vërtetësinë e të dhënave, me ndihmën e Zyrës Qendrore dhe kontrollorit të vend-depozitimit .

Kriteret: penalitet/gjorbë kumulative për çdo javë, apo pjesë të javës për vonesën. Penalitet/gjorbë edyfishtë nëse të dhënat janë të pasakta, të gjitha pasojat ligjore ruhen.

Penaliteti/gjoba: reduktim 2%, pastaj 4% pas javës tjetër dhe kështu me radhë, të faturës mujore të muajit vijues.

Kërkesat për ofertuesin

Ofertuesi duhet të tregojë se si ka ndër mend t'i ofrojë shërbimet si edhe aftësinë e tij për të garantuar sasinë dhe cilësinë e shërbimit.

Për këtë qëllim, ofertuesi duhet të paraqesë një plan pune që përfshin organizimin e parashikuar, materialet dhe personelin.

Ofertuesi duhet të paraqesë kontratën, nënkontratën dhe licencën e menaxherit të projektit, mekanikun përgjegjës për mirëmbajtjen e kamionëve si edhe për mekanikun përgjegjës për mirëmbajtjen e kazanëve metalikë.

Kandidati/operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme për ekzekutimin e kontratës dhe specififikimet e dhëna:

- 3 dhe 2 kamionë për grumbullimin e mbetjeve me kapacitet 10 ton dhe 1 kamion grumbullimi me kapacitet 5 ton në gjendje të mirë pune të pajisur me sistemin e duhur të ngritjes të pajtueshëm me kazanët e përdorur në Bashkinë Shkodër, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe normat e sigurisë si edhe në përmbushje të të gjitha pikave të përshkruara në kapitullin 1.3.
- 1 kamion për fshirjen e rrugëve (makinë fshirëse rrugësh teknologjike) me efikasitet të lartë për largimin e mbetjeve, gjetheve, baltës dhe pluhurit dhe një kapacitet fshirës më të madh se 140.000 m²/ditë, të pajisur me një sistem që pengon shpërhapjen e pluhurit në ajër (spërkatjen me ujë) me një gjerësi punuese minimale të kamionit prej 2 metrash, në përmbushje të të gjitha pikave të përshkruara në kapitullin 0.
- 1 kamion për larjen e rrugëve, të pajisur për spërkatjen e rrugës me ujë, me një gjerësi punuese minimale prej 2 metrash dhe rezervuar me kapacitet 10 metër kub, në përmbushje të të gjitha pikave të përshkruara në kapitullin 0.
- 1 kamion në gjendje të zëvendësojë kazanët në rrugët e qytetit, sipas nevojës.
- Disponueshmëria e një kamioni vetëngarkues apo një buldozeri për punën në landfill.
- Disponueshmëria e një makinerie për larjen e kazanëve.

Shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se ajo zotëron apo ka marrë me qira vend të mjaftueshëm për magazinimin e kamionëve dhe kazanëve.

Shoqëria duhet të vërtetojë kapacitetin profesional të saj për riparimin dhe mirëmbajtjen e kamionëve dhe makinerive.

Shoqëria duhet të vërtetojë kapacitetin profesional të saj për riparimin dhe mirëmbajtjen e kazanëve metalikë.

Propozimi i ofertuesit duhet të plotësojë kërkesat teknike, sasiore dhe cilësore të përshkruara në dokumentet e tenderit.

Çdo propozim alternativ i ofertuesit është i mundur (për sa kohë që sasia dhe cilësia e shërbimit është e njëjt) dhe duhet të miratohet nga Bashkia.